# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432127**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ekskluzive në |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/915049/video-ahmetaj-zbardh-pergjimin-skandaloz-ne-itali-eshte-kapur-nje-furgon-me-raketa-lufte/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 23:13:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 20:14:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d9c13b7e27a40fcfdc18e33fbd94191fddfde41f5e12427de0d3052a6397e1fc` |
| TEKSTI | `d0147bfdd68f4516dfd6c76fd00d131281d9760b37d254beabaea63f244b59ff` |
| PAMJA | `12d38dd4435766741e1bec1a7f783eae5dec712560326855da1685b481ac1c7b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2403127ac2446dde2d6d6dbb7874717694ebfccf1273b3166725a344387da3be` |
| E MËPARSHMJA | `86d8f78e4898cf729ad58b6f0867bd01588e8b438f6d33493f199a61c3709f1e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2403127ac2446dde2d6d6dbb7874717694ebfccf1273b3166725a344387da3be`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# VIDEO/ Ahmetaj zbardh përgjimin skandaloz: Në Itali është kapur një furgon me raketa lufte

**ZMADHO TEKSTIN22:14, 07/09/2026**

+ Aa -

*Gjatë intervistës ekskluzive në 'Çim Peka LIVE' në SYRI TV, ish-zv/kryeministri Arben Ahmetaj, ka akuzuar Edi Ramën se, i jep paratë e buxhetit të shtetit, Ron Yefet pa asnjë tender.*

*'Tani shikoni Timak Defense, pasqyrën financiare. Kanë marrë nga buxheti i shtetit miliarda lekë paradhënie pa pasur asnjë investim nga vetë kapitali i tyre. Është një kancer në trupin e shtetit.*

*Unë e shkruajta vetë në ligj për rindërtimin, s'bëra asnjë tender.', u shpreh Ahmetaj.*

**Pjesë nga intervista ekskluzive:**

**AUDIOPËRGJIMI – Episodi i katert:** VIDEO (Lart)

> **Transkripti**
>
> **Igor** flet në gjuhën ukrainase, përmend disa herë fjalën TIMAK dhe Ukrainë
>
> **Tatjana:** Opsioni që ne kemi që të ndjekim çdo mundësi, fonde, programe çtë jetë
> Të cilat janë zakonisht ato që ka nevojë qeveria jonë.
> Dhe qeveria jonë ka nevojë për armatime e makina ushtarake.
>
> Zakonisht si funksionon, përshembull kërkesa të caktuara, dhe ne themi që TIMAK është i gatshëm të furnizojë pa vështirësi dhe pastaj ne sigurojmë fondet. Kush është gati të financojë procesin dhe qeveria firmos fondet.
>
> Mund të jetë KAYO, TI, Furnitorë të NATO-s që mund të furnizoni… (Nuk kuptohet qartë)
>
> **Ron:** Cilat janë hapat
>
> **Tatjana** flet në gjuhën ukrahinase
>
> **Ron:** Një mënyrë tjetër për ta realizuar është të hapim një partneritet dhe bashkëpunim me qeverinë Ukrainase.
>
> **Tatjana:** Fatkeqësisht gjithçka bëhet me tender… (Vazhdon në gjuhën ukrainase)
>
> **Ron:** Kështu unë e bëra në Francë. E kam këtu. E bëra dhe në Itali
>
> **Tatjana** flet në gjuhën ukrahinase
>
> **Ron**: Pa tendera

**ARBEN AHMETAJ:** Është vazhdimi i logjikës së trafikut të armëve dhe po ta dëgjosh, pala tjetër i referohet tenderave. Ky, Roni, gjithmonë flet për 'pa tendera', sepse kreu i organizatës ia kalon paratë pa tender.

Kjo strukturë kriminale bëhet që nesër të ketë në dorë aortën ekonomike të vendit dhe t'ia shtrëngojë fytin çdo qeverie që vjen nesër.

**ÇIM PEKA:** I referohet Julian Hoxhajt?

**ARBEN AHMETAJ:** Po. Unë i ftoj gazetarët investigativë, shihni pak atë rastin kur në Itali u kap një furgon me raketa. Mund të zbuloni mbrapa gjëra shumë interesante të trafikut të armëve nga Greqia për në Shqipëri.

Tani shikoni Timak Defense, pasqyrën financiare. Kanë marrë nga buxheti i shtetit miliarda lekë paradhënie pa pasur asnjë investim nga vetë kapitali i tyre. Është një kancer në trupin e shtetit.

Unë e shkruajta vetë në ligj për rindërtimin, s'bëra asnjë tender. Dhe tani jam në luftë me një mafia në pushtet dhe në media.

**Çim Peka: Mua më intereson, mua më intereson më shumë nga të gjitha, në momentin një dhe dy, se si këta përdorin konceptin kriminal që i referohen, ka ky koncept, për të vjedhur pasuritë e shqiptarëve dhe paratë e buxhetit të shtetit. Kalojmë tek episodi katër.**

**Arben Ahmetaj:** Është vazhdimi i logjikës së trafikut të armëve. Dhe po ta dëgjosh, prapë i referohet tenderave. Ky... Roni, gjithmonë flet për pa tendera, sepse kreu i organizatës ja kalon paratë, do t'i shohim më pas, dhe paradhënie, pa tender. Prandaj e ka bërë këtë strukturë kriminale. Që praktikisht nesër t'i ketë në dorë këto kompani private dhe nesër një qeveri që do vijë, e dalë nga vullneti i popullit që do dalë shumë e fuqishme, të mos ketë mundësi të qeverisë Shqipërinë se ky do ketë në dorë aortën ekonomike të vendit dhe do t'ia shtrëngojë fytin çdo qeverie që do vijë nesër.

Çdo qeveri që do vijë nesër! Çdo qeveri që do vijë nesër do duhet të merret pikësëpari me arteriet financiare të kreut të organizatës. Se ndryshe kanceri në trupin e Shqipërisë nuk shërohet. Do t'ia bëjë të vështirë jetën shqiptarëve dhe çdo qeverie, nëse do t'i lihen gjaku i buxhetit të shtetit dhe i pasurive të shqiptarëve, ta përdori ky për të bërë të vështirë çdo lloj jete të çdo lloj qeverie, të kujtdo qoftë nesër.

Edhe të brinjës së vet po deshe të kësaj qeverie, prapë do t'ia bëjë të vështirë. Jemi duke folur për trafik armësh, ku një palë flet për tendera, Ukraina siç thonë nuk i bëjnë dot gjërat pa tendera, se jemi në sytë e Natos. Vendi i Natos i bën pa tendera se është vendi ku kreu i organizatës po shet çdo gjë.

Po shet çdo gjë! Ia bëra sfidë miqësore qytetarëve, me gjet në një pikë në hartë që s'e ka dhënë... Kudo. Në hartën e Shqipërisë. Pra vazhdojmë, jemi duke folur për trafik amësh, madje madje, një ngacmim të vogël gazetarëve investigativë jua bëj. Shiheni një çikë këtë rastin ku në Itali është kapur një furgon me raketa... lufte. Sigurisht. Shiheni një çikë. Se mund të zbuloni mbrapa gjëra shumë interesante. Shumë interesante, të trafikut të armëve. Shiheni një çikë, nuk është pa gjë. Unë deri këtu e lë gjënë. Këtë mundësi kam, këtë informacion kam, këtë informacion e ndaj me shqiptarët. Ky informacion ja vlen të ndahet.

Pra shikojeni, se mund të ketë lidhje. Janë disa raketa që janë kapur nga autoritetet italiane në jug të Italisë që vinin nga Greqia, për të... për të prodhuar në Shqipëri.

© SYRI.net

**Lexo edhe:**

- VIDEO/ Ahmetaj publikoi përgjimin në SYRI TV, protestuesi: Rama dhe Yeffeti, skema për shitjen e Shqipërisë
- Denoncimi/ Emigrantët shqiptarë bllokohen në Mal të Zi me urdhër të Ramës! Pengohen t'i bashkohen protestës
- VIDEO/ Tomorri ngre dyshime për Timak Defense: Ka deklarata kontradiktore, SPAK duhet të verifikojë

Më të lexuarat
Politikë

## Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në 'raportim të kufizuar', qeveria fshehu të vërtetën

Politikë

## Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit

Politikë

## SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si 'raketë' pyetjeve të Syri Tv për audiopërgjimin

Politikë

## SYRI TV/ 'Kufizimi i takimeve të Metës, shqetësim serioz' , Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313

Politikë

## Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Politikë

## Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar

Politikë

## SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK

Politikë

## SYRI TV/ Debate për audiopërgjimin e Ahmetajt, PD kërkon seanca dëgjimore për aferën

Politikë

## Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq, përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?

Politikë

## Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija

**TË NGJASHME**

Politikë

## Mediu për 11 Shtatorin: Bota ndryshoi përgjithmonë, shqiptarët krenarë që qëndruan në krah të SHBA

Politikë

## Televizioni francez: Protesta në Shqipëri është shndërruar në një mobilizim afatgjatë kundër modelit Rama

Politikë

## Skandaloze/ Nuri: Rama telefonoi protestuesin në administratë për ta frikësuar se pse proteston

Politikë

## A e ka marrë përsëri Allajbeu konçensionin?/ Diaverum fiton tenderin e dializës, grupi zotëron edhe DiaVita-n e PPP

Politikë

## Berisha denoncon: Ministri i ri i Brendshëm rrihet në zyrë, policia nuk e ndihmon

Politikë

## 'Territorialja' në Memaliaj/ Kryebashkiaku Albert Malaj dhe qytetarët braktis dëgjesën publike: Jo shkrirjes

Politikë

## Ministres pa emër, që i vjen ndot nga e vetmja pasqyrë që u ka mbetur socialistëve

- Lajme
  - Web TV
  - Kuriozitete
  - Arte & media
  - Sociale
  - English
  - Shëndet
  - Tjera
- Politikë
- Kronikë
- Ekonomi
- Kosova
- Botë
  - Rajoni
- Kulturë
- Shkencë
  - Teknologji
- Sport
  - Botërori 2026
- Jetë/stil
- Trashëgimi
  - Histori
- Mjedis
  - Klimë
- Arkiva

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Search

Denonco

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Në rregull!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.